



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

REFERENCË:			
PËR/ZA/TO:	Kryeministrit të Kosovës z.Ramush Haradinaj		
CC:			
PËRMES/PREKO/THROUGH:			
NGA/OD/FROM:	z.Vesel Krasniqi, zv.Ministër i MBPZHR		
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti për periudhen janar-mars 2018		
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No:	Lokacioni: Prishtinë Kucni: Extension:	Data: Datum: Date:	06/04/2018
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION			
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL <input type="checkbox"/>			
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE <input type="checkbox"/>			
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS <input type="checkbox"/>			
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY WE DISCUSS <input type="checkbox"/>			
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION <input type="checkbox"/>			
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED <input type="checkbox"/>			
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED <input type="checkbox"/>			
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN <input type="checkbox"/>			
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION <input checked="" type="checkbox"/>			
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE			

I nderuari z.Kryeminister Haradinaj ,

Po ju informojë përmes këtij raporti lidhur me punën time si zv.Minister në MBPZHR nga data: 04.01.2018 deri me 30.03.2018

- Me datën 04/01/2018 kemi mbajtur një takim në Ministrinë e Bujqësisë me përfaqësuesit e UNHCR-së (Agron Berisha),poashtu prezentë ishin edhe përfaqësues nga AVUK-u,Shoqata e Mullistëve,Shëndetsia dhe përfaqësuesi i Konsumatorëve.
Në këtë takim u diskutua për zbatimin e Ligjit dhe udhëzimeve administrative që kanë të bëjnë me Acidin Folik dhe pasurimin e miellit me hekur.U diskutua se deri më tani pjesërishtë është zbatuar ky Ligj nga Mullistët për shkakë të disa vështirësive që ata paraqiten,por u zotuar të gjithë së bashku që në vitin 2018 do të zbatohet në përpikmëri Ligji me një bashkëpunim nga të gjithë akterët.U tha se në fillim pasurimi i miellit me acidin folik është pasuruar 80% ndërsa tani 25%,pastaj rrethë 33% e miellit vendor nuk pasurohet.Pra ne si përfaqësues të MBPZHR-së u ofruam mbështetjen tone lidhur me evitimin e pengesave dhe zbatueshmerinë e këtij ligji në përpikmëri.
- Poashtu këtë ditë në ora 16⁰⁰ përfaqsova Ministrin në mbledhjen e 23-të të Qeverisë së Kosovës ku u diskutuan 7 pika të rendit të ditës: 1.Procesverbali nga mbledhja e kaluar,2.Shqyrtimi i draftit të strategjisë së sektorit për punsim dhe mirqenje sociale,3.Shqyrtimi i planit të veprimit për rritjen e punsimit të rinjëve,4.Shqyrtimi i nismës së Marrveshjes në fushen e shëndetsisë në mesë të Kosovës dhe Japonisë,pika 5 dhe 6 ishin shqyrtimi i propozim vendimit për shpronsimin e disa pronave për rrugët publike,7.Shqyrtimi i project rregullore për shërbimet e transportit.
- Me datën 09/01/2018 u takuam me Ministrin e Bujqsisë z.Rikallo lidhur me organizimin e një puntorie për programin zhvillimor për të përcaktuar kriteret për subvencione dhe grante për vitin 2018.Poashtu u bisedua për detyrat e reja që do të kem si përgjegjësi gjatë vitit 2018 në fushën e buxhetit dhe financave,mbikqyrjen dhe zbatueshmerinë e ligjeve dhe akteve nënligjore si dhe aktivitete tjera sipas nevojave.
- Me datën 09/01/2018 kisha një takim me shefin e AVUK-ut z.Valdet Gjinovci në zyren e tij,ku biseduam për të arriturat dhe sfidat e këtijë

agjensioni. Biseduam për disa masa që duhet të mirren lidhur me disa produkte ushqimore, të shtohen inspektimet në kufij dhe Brenda vendit. Poashtu u bisedua për mundësin e një Memorandumit në mes të Agjensionit dhe Ministris së Mirqenjes sociale lidhur me ndihmën në aspektin e punsimit ku ky agjension ka nevojë për inspector shtesë për luftimin e dukurive negative sa i përketë ushqimit.

- Poashtu me datën 09/01/2018 jemi takuar me Ministrin e MPS-së z. Skender Reqica së bashku me Shefin e Agjensionit të Pyjeve z. Ahmet Zejnullahun, ku jemi dakorduar që të nënshkruhet një Memorandum bashkpunimi për projektin e mbrojtjes së pyjeve nga zjarri, pyllzimin e pyjeve dhe ruajtjen e tyre për vitin 2018. Në këtë projekt do të përfshihen 170 puntor nga të gjitha regjionet, të cilët do të pranohen përmes Entit për Punsimin.
- Me datën 12, 13 dhe 14/01/2018 në Pejë është mbajtur puntori nga MBPZHR-ja për të diskutuar Draft Programin Zhvillimor të Pagesave direkte përmes Subvencioneve dhe Grandeve për vitin 2018. Në këtë takim morën pjesë Ministri i Bujqësisë z. Nenad Rikallo, tre zv. Ministrat dhe Drejtorët e Departamenteve në kuader të kësaj Ministrie. Në fund të kësaj puntoria u konkludua se duhet të ndrohen disa kriterë në favor të Fermerëve që do të nënshkruhet nga Ministri z. Rikallo. Ftesa për aplikim do të fillojë në muajin shkurt dhe afati për aplikim do të zgjasë 45 ditë.
- Me datën 17/01/2018 I kam vizituar dy ferma në Komunën e Prizrenit njëra në Korishë dhe tjetra në Serbicë, ku u njoha me punën e tyre, vështirësitë dhe kapacitetet e tyre. Në Korishë pronari kishte mbi 400 copa dele I cili nuk kishte përfituar asnjë ndihmë nga shteti dhe kishte nevojë urgjende për një shtall sepse delet I mbante në sera. Ndërsa te fermeri në Serbicë pam se fermeri kishte 90 cop bika duke I rritur për mish I cili I kishte të sistemuar në një shtallë jo në kushte të mira, e që kishte nevojë dhe mbeshtetje nga shteti përmes grandeve.
- Me datën 23/01/2018 kam qenë në takim te shefi I Agjensionit Zhvillimor z. Elami Hajdari me të cilin biseduam lidhur me pregaditjet për vitin 2018 me stafin ku deklaroj se ka mungesë si dhe formën e funksionimit të komisioneve në përcaktimin e subvencioneve dhe grandeve. Poashtu u dakorduar që të bëjmë një Memorandum bashkpunimi në mesë të dy

Agjensive të AZHB-së dhe Agjensionit punsimit në MMPS-në. Bashkpunimi do të jetë në funksion të shtimit të efikasitetit në përcaktimin dhe monitorimin e Subvencioneve dhe grandeve me shtimin e stafit në këtë fushë.

- Me datën 24/01/2018 kisha një takim me Shefin e Agjensionit të AVUK-ut z.Valdet Gjinovcin ku biseduam që të inspektohen Mullinjët lidhur me përdorimin ose mospërdorimin e acidit folik në miell. Poashtu edhe për disa artikuj ushqimor të inspektohen dhe të menagjohen më mire nga ky agjension për produktet që importohen. Shefi i këtijë Agjensionit u ankua lidhur me nr.e vogël të inspektorëve për ti luftuar të gjitha dukurit negative në kohën optimale.
- Me datën 29/01/2018 ishim në përrurimin dhe funksionalizimin e laboratorit për analiza bujqësore dhe serrave eksperimentale, për zhvillimin e mundeve të mëtutjeshme në sektorin e bujqsisë sipas standardeve Evropiane. Ky project është mbështetur nga “KosAgri” I cili financohet nga Qeveria e Italisë dhe ka për qëllim të ngris sektorin e sinjalizimit dhe parandalimin e semundjeve bimore .
Ne fund vizituam edhe hapsirat e objektit të laboratorit.
- Me datë 29.01.2018 ishim edhe në Rahovec në përrurimin e objektit të Vreshtarisë dhe Vertarisë, edhe ky project është financuar nga “KosAgri”. Me këtë rast falenderuam miqët nga Italia që na mbështetën më këtë projektë në ngritjen e objektit dhe Serave, si dhe për përvojat dhe praktikave të tyre. Pastaj vazhduam të vizitojmë hapsirat e objektit dhe serat, si dhe në fund vizituam një prej bodrumeve më të vjetra në Republikën e Kosovës “Stone Castle”.
Verën e Rahovecit e cilësuam si një prej ambasadorëve të Kosovës sa I përket përfaqsimit të produkteve vendore që eksportohen jashtë shtetit të Kosovës.
- Me datë 02/02/2018 patëm takim me biznesmen turk (investitor) , biseduam për mundësinë e bashkëpunimit. Ishin të interesuar të investojnë në prodhimin e Fidaneve të forta, gjithmonë në bashkëpunim më Ministrinë e Bujqësisë.
- Me datë 02/02/2018 mbajtëm takim me Kryetarin dhe disa përfaqësues të Shoqatës së Qumështarëve dhe me Fermerë. Diskutuam për problemet dhe

shqetësimet që ballafaqohen çdo ditë, kërkuan që ti shikojnë mundësitë e bashkëpunimit me Ministrinë tonë, si dhe kërkuan që të merren parasysh kërkesat e tyre, pasi thanë që e kanë problem të arrijnë objektivat dhe qëllimet e tyre kështu të vetëm.

- Me datë 07/02/2018 mbajtëm konferencën e hapjes së Projektit të Binjakëzimit, Mbështetje kjo në fuqizimin e kapaciteteve të sistemit të prodhimit dhe mbrojtjes së bimëve në Kosovë, projekt I shtetit të Letonisë. U tha që ky projekt është I rëndësishëm sepse kjo ndihmon në arritjen e standardeve më të larta sa I përket krijimit të bazës ligjore në fushën fitosanitare që ka përqendrim kontrollin që ndikon në mbrojtjen e njerëzve, kafshëve dhe ambientin jetësorë. E rëndësishme është që të ketë sa më shumë rezultate dhe të arrihen qëllimet për të cilat është bërë ky projekt.
- Me datë 07/02/2018 mbajtëm takim me z.v. Ministrin e MTI-së Faton Thaci dhe ushtruesin e detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Pronës Intelektuale z. Isa Dukaj, ku tem diskutimi ishte koordinimi I aktiviteteve të përbashkëta të projektit për ndertimin e një treguesi gjeografik për djathin e Sharrit. Kërkuan përkrahje nga MBPZHR për këtë projekt dhe u dakordua të formojmë dy grupe punuese profesionale nga të dy ministrinë sepse është një aktivitet në bashkëpunim me ambasaden franceze, dhe pse mos të dihet origjina e djathit të Sharrit kur dihet që prejardhjen e ka prej aty.
- Me datë 10/02/2018 patëm takim me Fermerë në Komunen e Malishevës, prezent ishte edhe Drejtori I Bujqësisë në këtë Komunë z. Murat Hoxha dhe z. Milaim Morina nga MBPZHR. Në këtë takim të pranishëm ishin rrethë 100 fermerë, ku u diskutua rreth sfidave dhe problemeve që përballen fermerët e kësaj Komune, gjithashtu I informuam lidhur me kriteret e përcaktuara për vitin 2018 për subvencione dhe grande, dhe për ndryshimet që janë bërë në këtë vitë.
- Me datë 27/02/2018 mbajtëm takim me Ministrin z. Rikallo ku diskutuam për kriteret e përcaktuara për Grande dhe Subvencione e që pritet të publikohen deri në fund të javës, gjithashtu u bisedua lidhur me udhëzimin administrativ për Praktika Veterinare, gjithashtu u diskutua edhe për buxhetin 2018 dhe obligimet nga viti 2017.
- Me datë 28/02/2018 patëm takim në Komunen e Therendës me Kryetrin e kësaj Komune z. Bali Muharremaj, gjithashtu I pranishëm ishte edhe

zv.Ministri i Administratës Publike z.Sami Hajdaraj. Z.Muharremaj na njoftoi me planet që ka për zhvillimin e sektorit të bujqësisë në Komunen e Therandes,ku theksojë se do ta formojë Odën e bujqëve e cila pastaj do të jetë në kontakt me fermerë të të gjitha fshatrave etj. I premtuam se Ministria e Bujqësisë vitin e ardhshëm do të shtojë buxhetin për fermerë dy fishë më shumë se sa e ka tani sepse Komuna e Therandes ka fermerë shumë të mirë ,të zotë dhe punëtorë dhe besojë qe shumica nga ta do jenë përfitues te granteve qe I ka Ministria e Bujqësisë.

- Me datë 08/03/2018 mbajtem takim me Drejtorin e bujqësisë si dhe me Drejtorin e Administratës të Komunës së Therendës.Në Këtë takim u diskutua për bujqësinë në Therandë,mundësishtë buxhetore për përkrahjen e Fermerëve nga niveli local dhe ai qendrorë.U sigurua për një bashkpunim të mire dhe mbështetje fermerëve të kesaj Komune të cilët në të kaluaren kanë qenë pa përkrahje nga niveli qendrorë.U dakorduam që të mbajmë një takim me fermerët e kësaj Komune me datë 21.03.2018.
- Me datë 19/03/2018 mbajtem takim me Shoqaten suedeze te Gjuetisë,ku diskutuam për interesimin e tyre që të investojnë në fushën e gjuetisë,respektivisht në rritjen e kafshëve si dhe në gjietinë e kafshëve të egra.Nesër do ta vizitojnë terenin e Blinajës për të parë nga afër pjesët në të cilat janë të interesuar të investojnë dhe pas kësaj pritet që në bazë të procedurave dhe ligjeve të sjellin projektin konkret me të cilin mendojnë të investojnë.
- Me datë 21/03/2018 me ftesë të Drejtorit të Bujqësisë në Komunen e Therandës mbajtëm takim me Fermerët e kësaj Komune ku diskutuam lidhur me subvencionet dhe grandet për vitin 2018,si dhe bashkëbiseduam për pyetjet që i parashturan lidhur me shqetësimet e tyre.

•



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural –
Ministarstvoza Poljoprivrede, Sumarstva i Ruralnog Razvoja–
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

- 1. Zv. Vesel Krasniqi, (dorëzuar me datë 06.04.18 – 6 faqe)**
- 2. Zv. Jeton Emini, (është emruar që një muaj))**
- 3. Zv. Shukri Maxhuni, (dorëzuar)**
- 4. Zv. Muvledin Krasniqi, (është emruar që një muaj)**